

Nëse je fëmijë nën moshën 18 vjeç, viktimë apo dëshmitar i një veprë penale, ti gëzon të drejta dhe mbrojtje të veçantë!

Nëse ti vendos të dëshmosh

Policia, prokurori, gjyqtari, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, avokati dhe psikologu do të kujdesen për ty. Ata do të të mbështesin, këshillojnë dhe do të të mbrojnë.

Ti do të trajtohesh me respekt dhe me dinjitet!



Ti ke të drejtë

- ✓ Të informohesh në vazhdimësi mbi të drejtat e tua, procesin, shërbimet e masat mbrojtëse që përfiton.
- ✓ Të kesh të pranishëm prindërit, kujdestarin apo një person të besuar.
- ✓ Të kesh një avokat falas, i cili do të të mbrojë ty dhe do të të tregojë çfarë do të ndodhë hap pas hapi.
- ✓ Të kesh një psikolog falas i cili do të të mbështesë gjatë gjithë procesit.
- ✓ Të kërkoh një interpretues apo lehtësues falas nëse ke vështirësi në dëgjim, të folur, shikim etj.

Kujdes!

Nëse nuk e kupton informacionin kërko të ta shpjegojnë më thjesht e më qartë.

Jeta jote private është e mbrojtur!

Askush nuk lejohet të publikojë emrin, foton apo të dhënat tua dhe të familjes tënde.

Në seancat gjyqësore nuk do të lejohet pjesëmarrja e publikut.

Do të merren masa për të mos lejuar identifikimin tënd.



Kujdes!

Refuzo t'u përgjigjesh pyetjeve në lidhje me jetën tënde private dhe që nuk kanë lidhje me procesin

Siguria jote fizike dhe emocionale, do të jetë e garantuar

Policia, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, prokurori ose gjyqtari do të ndërhyjnë menjëherë dhe në çdo kohë për të:

- të mbrojtur nëse ndihesh i rrezikuar;
- shmangur çdo kontakt me të akuzuarin;
- mos lejuar identifikimin tënd.



Nëse ndihesh i lodhur gjatë dhënies së dëshmisë mos ngurro ta shprehësh, të kërkoh pushim, plotësimin e nevojave të tua si dhe të caktosh kohën kur ndihesh i gatshëm për të dëshmuar

Nëse je viktimë, ti ke të drejtë të kompensohesh për dëmin që të është shkaktuar duke:

- u përfshirë në programe të posaçme që synojnë që ti edhe i akuzuari për veprën penale të bini dakord për kompensimin e dëmit që të është shkaktuar;
- kërkuar në gjykatë kthimin dhe kompensimin e dëmit.



Procesi do të jetë i shkurtër!

Policia, prokuroria apo gjykata, do të marrin masa në mënyrë që ti të pyetesh:

- sa më pak herë që të jetë e mundur;
- në orare dhe mjedise të përshtatshme për ty;
- për një kohë jo të gjatë;




Ndalohet marrja në pyetje e të miturit gjatë natës, gjatë orarit;

22:00 – 08:00.

Nëse ke nevojë për ndihmë dhe mbështetje apo nëse të drejtat e tua janë cenuar:

Kontakto punonjësin për mbrojtjen e fëmijës të zonës ku ndodhesh. Numrin e tij e gjen në faqen e internetit:

<http://femijet.gov.al/al/njesite-per-mbrojtjen-e-femijeve>



**Telefono falas:
Alo 116 111**



Je dëshmitar apo viktimë e një
vepre penale?
Ti do të jesh i mbrojtur!

Lexo të drejtat e tua!



**Tiranë, maj
2021**



Norwegian Ministry
of Foreign Affairs



A.L.T.R.I

unicef 
for every child

Për më shumë informacion mbi të drejtat e të miturve viktimë apo dëshmitarë të veprave penale konsultoni faqet e internetit të:

Qendrës për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve: <http://www.qpkmr.gov.al>

UNICEF Shqipëri: <https://www.unicef.org/albania/sq>

Qendra ALTRI: <http://www.altri.al>

Ky material u përgatit nga Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (Qendra ALTRI) për Ministrinë e Drejtësisë dhe Zyrën e UNICEF-it në Shqipëri, me mbështetjen financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë